



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 196, Datë 18.09.2024

MBI

DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SH.A.
PËR VENDOSJEN E AKSIONEVE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E
DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1774/6 prot., datë 17.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aksioneve të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”

Konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 248, datë 29.09.2022 dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 238, datë 22.09.2022.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1174 prot., datë 19.08.2024, shoqëria ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aksioneve të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit të marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, me shkresën nr. 1774/2 prot., datë 04.09.2024, ERE i evidentoi shoqërisë informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1774/1 prot., datë 11.09.2024, shoqëria ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e munguar.
- Autorizimi i ERE-s do të jepet për pjesën takuese të aksioneve për të cilat është dhënë miratimi përkatës nga organet drejtuese të shoqërisë dhe për të cilat është nënshkruar marrëveshja siguruese me bankat pra për 90 % të aksioneve të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a., të zotëruara nga “AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI”.
- Po ashtu, duke qenë se nga dokumentacioni i depozituar për qëllime këtij aplikimi rezulton se mbi aksionet e shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. është vendosur tashmë një barrë siguruese e rradhës së parë për të siguruar një detyrim tjetër që shoqëria ka ndaj të tretëve. Autorizimi i ERE-s për barrësimin e 90% të aksioneve të saj, në favor të bankave sindikale, do të jetë i rradhës së dytë. Ky vendim do të jetë objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton në ERE heqjen e barrës siguruese të radhës së parë mbi aksionet e saj të vënë në favor të bankës turke. Vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi aksionet ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Shoqëria ka depozituar në ERE konfirmim e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) të drejtën e koncensionarit për të vendosur barrë, hipotekë, peng apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve, ose aksionet, si dhe të lidhë çdo marrëveshje financimi me çdo pale financuese, me kusht që hipoteka, peng apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t’i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të koncensionarit në kontratë. Vlerësohet të sqarohet se dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e aksioneve të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e barrës siguroese të rradhës së dytë mbi 90% të aksioneve të shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a (nga “AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI”), si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit të marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Raiffeisen Bank” sh.a.
2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “AYEN AS ENERGJI” sh.a. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi aksionet ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e barrës siguroese të radhës së parë të vendosur mbi aksionet e saj.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI